



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 1259/prot
2

Tiranë, më 21/09 2020

URDHËR

Nr. 178/datë 21.09 2020

MBI

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 722, DATË 11.11.2019 "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL DHE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË TYRE"

Bazuar në ligjin nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në RSH", pikat 4 dhe 16 të kreut IV të vendimit nr.722, datë 11.11.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre", gërmat "a", "b", "c" dhe "ç" të pikës 2 të kreut IV të vendimit nr. 431, datë 8.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot", i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 135, datë 7.03.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Statusit të Shërbimit Social Shtetëror",

URDHËROJ:

1. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 2, të kreut IV, të vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 të Këshillit të Ministrave, është 11,541 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma "a", të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 6,907 (gjashtëmijë e nëntëqind e shtatë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma "b", të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 9,209 (nëntëmijë e dy qind e nëntë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

4. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “c”, të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 11.511 (njëmbëdhjetëmijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

5. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “ç”, të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 13,813 (trembëdhjetëmijë e tetëqind e trembëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

6. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmësit personal, është 13,813 (trembëdhjetëmijë e tetëqind e trembëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

7. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 17, të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, të Këshillit të Ministrave për shërbimet e herëpashershme të ndihmësit personal, është 9,209 (nëntëmijë e dy qind e nëntë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.09.2020.



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lunedha Sufali